



Republika e Kosovës

Republika Kosova-Republic of Kosovo

Qeveria - Vlada - Government

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal

Ministry of Local Government Administration



HELVETAS
KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA GLLGOC
MUNICIPAL GLLGOC

01 Nr. - 400/01-16472

Më 27.05.2020

Prishtinë, 15.04.2020

Nr. 078/2020

Nr. 454-22512

Data 24.04.2020

Në mbështetje të nenit 8, 9, 10, 11 të Ligjit Nr. 06/L-113 për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratës Shtetërore dhe Agjencive të Pavarura, nenin 8, paragrafi 1.4 të Rregullores (QRK) Nr. 05/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, nenin 5 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, Ligjin Nr. 07/L-001 për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, në pajtim me Marrëveshjen ndërmjet MAPL-së, Komunës së Glllogocit dhe Helvetas Swiss Intercooperation për Pjesëmarrje në Grantin e Performancës Komunale, si dhe Vendimin e Komisionit të Grantit të Performancës Komunale me të datës 31.03.2020, arrihet kjo:

MARRËVESHJE PËR MBËSHTETJE FINANCIARE TË PROJEKTIT "Ndërtimi i kolektorve për grumbullimin e ujërave të zeza" NGA SKEMA E GRANTIT PËR PERFORMANCË KOMUNALE (GPK)

Ndërmjet:

1. Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, përfaqësuar nga Ministri i MAPL-së (në tekstin e mëtejme MAPL),
2. Helvetas Swiss Intercooperation, përfaqësuar nga Drejtori i Projektit DEMOS (në tekstin e mëtejme DEMOS) dhe,
3. Komunës së Glllogocit, përfaqësuar nga Kryetari i Komunës (në tekstin e mëtejme Komuna).

Neni 1
Qëllimi

1. Palët nënshkruese të kësaj marrëveshje kanë për qëllim zbatimin e kriterëve, parimeve, procedurave dhe rregullave ligjore të bashkëfinancimit dhe shpenzimit të mjeteve materiale konform dispozitave të kësaj marrëveshje dhe në pajtim me Rregullat e Grantit të Performancës Komunale (GPK)
2. Marrëveshja parasheh të drejtat dhe detyrimet e palëve në respektimin e rregullave të përcaktuara për bashkëfinancim të projektit, afatet dhe kushtet e tjera kontraktuale për subjektet juridike, me qëllim të shfrytëzimit të drejtë të grantit të performancës komunale dhe rritjes së efikasitetit të komunave në qeverisjen demokratike, menaxhimin komunal dhe ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarë.

Neni 2
Objekti i Marrëveshjes

1. Kjo marrëveshje ka për objekt bashkëfinancimin e projektit si vijon:

“Ndërtimi i kolektorve për grumbullimin e ujërave të zeza” fshati Dobroshec

Neni 3
Vlera e projektit dhe mënyra e bashkëfinancimit

1. Shuma totale e projektit në vlerën e parallogaritur është 420,000.00 €
2. Shuma totale e ndarë nga GPK për vitin 2020 (pjesa e DEMOS) është 287,151.00 €
3. Komuna nga buxheti i saj vjetor 2020 financon këtë projekt në shumën 132,849.00 €
4. Çfarëdo vlere tjetër që tejkalon shumën e paracaktuar të projektit, financohet nga buxheti i komunës.

Neni 4
Të drejtat dhe detyrimet e MAPL-së

1. Për projektet të cilat financohen nga buxheti i MAPL-së si pjesë e GPK-së, MAPL zotohet që:
 - a) Të sigurojë zotimin e mjeteve financiare sipas nenit 3.2 e kësaj marrëveshjeje. Një kopje e zotimit të mjeteve i dërgohet komunës. Të kryej obligimet financiare në bazë të realizimit të punimeve/furnizimeve sipas kushteve të kontratës.
 - b) Të monitoroj projektin në vazhdimësi dhe bashkëpunoj me komunën për sigurimin e informatave të rregullta rreth mbarëvajtjes së aktiviteteve sipas kushteve të kontratës.
4. MAPL nuk mban përgjegjësi në rast të dështimit të projektit për shkaqe të cilat nuk ndërlidhen me autorizimet e saja, si dhe në rast të ndryshimeve të mundshme të çfarëdo natyre ose shkeljeve që mund të ndodhin gjatë zbatimit të projekteve që bien në përgjegjësi të komunës.

Neni 5
Të drejtat dhe detyrimet e DEMOS

1. Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC), Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar (SIDA) dhe Ministria Norvegjeze e Punëve të Jashtme (NMFA) përmes projektit DEMOS, bashkëfinancojnë Grantin e Përformancës Komunale me MAPL-në, për 4 vitet 2018-2021, në pajtim me Rregullat e GPK-së.
2. Për projektet të cilat financohen nga buxheti i projektit DEMOS si pjesë e GPK-së, DEMOS zotohet që të bashkëpunojë me MAPL-në dhe ministrinë përkatëse për sigurimin e transferit në buxhetin e komunës të shumës financiare të paraparë për projekt sipas nenit 3.2 të kësaj marrëveshjeje.
3. DEMOS në bashkëpunim me MAPL-në dhe komunën, mund të sigurojë informata rreth projektit të financiar.

4. DEMOS nuk mban përgjegjësi në rast të dështimit të projektit për shkaqe të cilat nuk ndërlidhen me autorizimet e saja, si dhe në rast të ndryshimeve të mundshme të çfardo natyre ose shkeljeve që mund të ndodhin gjatë zbatimit të projekteve që bien në përgjegjësi të komunës.

Neni 6 **Të drejtat dhe detyrimet e komunës**

1. Komuna ka të drejtën e financimit të projektit sipas nenit 2 të kësaj marrëveshjeje nga GPK.
2. Në rast të bashkëfinancimit nga komuna, kjo e fundit obligohet të jap kontributin e saj financiar për zbatimin e projektit në shumën e përcaktuar në nenin 3.3 të kësaj marrëveshjeje.
3. Komuna, pas nënshkrimit të kësaj marrëveshjeje, obligohet të dërgoj në MAPL informatat e nevojshme për hartimin e PiP (Projekti i Investimeve Publike) me qëllim të fillimit të procedurave për sigurimin e zotimit të mjeteve të dala nga kjo marrëveshjeje
4. Nëse pas procedurave të prokurimit, shuma e projektit rezulton më e ulët se vlera e paracaktuar në nenin 3.1 të marrëveshjes, komuna është e detyruar të zvogëlojë kontributin e saj, ndërsa shuma e GPK-së mbetet e njëjtë.
5. Komuna obligohet të zhvillojë projektin në përputhje me këtë marrëveshjeje dhe kornizën ligjore në fuqi.
6. Komuna obligohet që pas nënshkrimit të kontratës me Operatorin Ekonomik (OE), të sjellë në MAPL një kopje të kontratës dhe ofertën financiare identike me origjinalin, së bashku me informatat për biznesin me qëllim të nxjerrjes së urdhër blerjes, si vijon:
 - certifikatën për regjistrimin e biznesit;
 - certifikatën e numrit fiskal;
 - kopjen e kartelës bankare të OE ose vërtetimi nga banka;
 - kopjen e dokumentit identifikues të pronarit të biznesit.
7. Komuna obligohet që të informojë DEMOS-in për vlerën finale të projektit të bashkëfinancuar me këtë marrëveshjeje pas përfundimit të procedurave të prokurimit.
8. Komuna cakton projekt menaxherin/organin mbikëqyrës për mbikëqyrjen e kryerjes së punimeve dhe komisionin i cili lëshon certifikatën e pranimi të punimeve/pranimin teknik.
9. Komuna është e detyruar t'ia sigurojë MAPL-së dhe DEMOS-it, kopjet e të gjitha dokumenteve për përmbylljen e projektit përfshirë:
 - kopjen e pranimi teknik si konfirmim zyrtar për përfundimin e projekteve dhe
 - shumën finale të projektit.
10. Komuna obligohet që të njoftojë MAPL-në dhe DEMOS-in për çdo propozim ndryshim eventuale të sasisë dhe kualitetit gjatë implementimit të projektit. Për projektet e financuara nga buxheti i MAPL-së si pjesë e GPK-së, Komuna duhet të merr aprovim paraprak në rast të nevojës për zhvillimin e punimeve shtesë.
11. Komuna obligohet të informojë MAPL-në për dinamikën e punimeve deri në përfundim të projektit.

12. Projektet janë të çasshme në çdo kohë për auditim të rregullt vjetor që kryhet nga Zyra Kombëtare e Auditimit në Kosovë (ZKAK) ose për auditimet e kërkuara nga DEMOS-i dhe/ose donatorët e tij për projektet e financuara nga buxheti i DEMOS si pjesë e GPK-së.

Neni 7

Dokumentacioni i nevojshëm i komunës për pagesë të projektit të financuar nga buxheti i MAPL

1. Komuna obligohet që për të realizuar pagesat për punët/furnizimet e kryera të kompletojë dokumentacionin si në vijim:

1.1. Kopjen e Kontratës të nënshkruar së bashku me Kushtet e përgjithshme, të veçanta dhe ofertën financiare e cila duhet të jetë identike me origjinalin e vërtetuar nga menaxheri i prokurimit të komunës.

1.2. Vendimin për caktimin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës/komisionin e pranimi nga ana e Komunës, në rast se nuk është e definuar me kushtet e veçanta në kontratë.

1.3. Raportin e projekt menaxherit/organit mbikëqyrës, komisionit të pranimi mbi punët/furnizimet e kryera të aprovuara (origjinali).

1.4. Faturën nga operatori ekonomik dhe situacionin e aprovuar (origjinali).

1.5. Sigurimin e ekzekutimit, garancionin e kualitetit me pranim teknik sipas kushteve të kontratës.

Neni 8

Afati i realizimit të projektit

1. Komuna duhet të ndërmerr të gjitha masat që projekti të përfundojë brenda vitit buxhetor 2020.

2. Pas përfundimit të afatit të përcaktuar në paragrafin 1 të këtij neni, të gjitha detyrimet i bartë Komuna.

3. Nëse projekti nuk përfundohet gjatë vitit fiskal 2020, për projektet që financohen nga buxheti i DEMOS si pjesë e GPK-së, fondet e pashpenzuara nga neni 3.2 kthehen në DEMOS dhe do t'i shtohen shumës së përgjithshme të GPK-së për vitin 2021.

Neni 9

Pronësia e projektit

1. Pas pranimi teknik të projektit nga Komuna, projektet e bashkëfinancuara sipas kësaj marrëveshje do të transferohen në pronësi të Komunës.

2. Komuna është e detyruar të regjistrojë projektet nën pronësi të saj brenda sistemit të aseteve të Ministrisë së Financave dhe Transfereve (SIMFK).

3. Projekti kalon në pronësi të komunës në rastin kur pasuria jo financiare i ka kaluar të gjitha rregullat dhe procedurat e dorëzimit, pagesën e fundit me pranim teknik, kur MAPL i kryen të gjitha pagesat e situacioneve dhe kur komuna e kryen pagesën - situacionin e fundit me pranim teknik. Me këtë rast, MAPL mbyll llogarinë e investimeve, ndërsa Komuna, pasurinë jo financiare të pranuar nga MAPL e regjistron në regjistrat e pasurisë jo financiare të saj.

Neni 10 **Ndryshimet dhe ndërprerja e Marrëveshjes**

1. Marrëveshja mund të ndryshohet dhe plotësohet sipas pëlqimit paraprak të MAPL-së, DEMOS-it dhe Komunës.
2. MAPL dhe DEMOS mbajnë të drejtën e ndërprerjes së Marrëveshjes në rast se Komuna nuk i përmbahet kushteve të kësaj marrëveshje.

Neni 11 **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**

1. Palët janë pajtuar që mosmarrëveshjet e mundshme të zgjidhen me mirëkuptim.

Neni 12 **Hyrja në fuqi**

1. Kjo marrëveshje hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit të saj nga MAPL, DEMOS dhe Komuna.
2. Kjo marrëveshje është nënshkruar në gjuhën shqipe, serbe dhe angleze në tri (3) kopje autentike, një për secilën nga palët nënshkruese.


Emilija Redžepi
Ministre e MAPL-së


Norbert Pils 
Drejtor i projektit DEMOS


Ramir Lladrovci
Kryetar i Komunës së Gllagocit

